



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020” .
2. Shqyrtimi në parim dhe paraqitja nga ministri i Shtetit për Diasporën i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Fatmir Velaj, Alket Hyseni, Ligoraq Karamelo, Rudina Hajdari, Amra Barova, Ediola Braha dhe Bashkim Fino.

Mungojnë:

Elona Hoxha, Evis Kushi, Ditmir Bushati, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Ervin Bushati, Zef Shtjefni, Halil Valteri dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Pandeli Majko - Ministër i Shtetit për Diasporën

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Elona Bano – Drejtoreshë e Kabinetit në Ministrinë e Diasporës

Vilma Causholli – Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 14 nëntor 2019.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e kalendarit “Për projektbuxhetin e vitit 2020”, si dhe shqyrtimin në parim dhe paraqitjen nga ministri i Shtetit për Diasporën i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Të ftuar kemi zotin Pandeli Majko, ministër i Shtetit për Diasporën, zotin Elton Haxhi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, zonjën Elona Bano, drejtoreshë e Kabinetit në Ministrinë e Diasporës. Mirë se erdhët!

Mendoj se jemi në kohën e duhur për të filluar diskutimin në parim të projektligjit “Për projektbuxhetin e vitit 2020”.

Kolegë, ju informoj se sot nuk do të ketë votim, thjesht do ta diskutojmë në parim dhe më pas do ta diskutojmë nën për nën në një datë, për të cilën do të biem dakord pasi të miratojmë kalendarin. Do t’ju lutesha të shikoni kalendarin për projektbuxhetin, sepse ditët janë të ngarkuara, komisionet janë të ngarkuara me diskutimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”. Kështu që mund të kemi edhe ndonjë ndryshim, por, gjithsesi, kjo do të kërkohet me mirëkuptim.

Në kalendar do të shikoni se nuk ka një datë të caktuar në lidhje me paraqitjen e projektbuxhetit nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, për shkak të mungesës së përgjigjes së saktë nga ana e kabinetit të ministrit në lidhje me datën kur ministri do të jetë prezent. Kështu që jemi në pritje të kësaj përgjigjeje. Ndërkohë, ne do të vazhdojmë me ministrin e Shtetit për Diasporën në përmbushje të detyrimit tonë si Komision për Politikën e Jashtme.

Atëherë, nëse e keni parë kalendarin për projektligjin, kërkoj edhe një herë mirëkuptimin tuaj, sepse mund të ketë ndonjë ndryshim në kalendar bazuar në ngarkesën dhe intensitetin e punës së komisioneve.

Kush është dakord në parim me kalendarin?

Miratohet!

Zoti Ministër, ju kërkoj ndjesë për vonesën, në mënyrë shteruese dy fjalë në lidhje me çfarë përfaqëson buxheti për vitin që vjen në ministrinë që ju drejtoni?

Faleminderit!

Pandeli Majko – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Buxheti në parim i vitit 2020 parashikon funksionimin në mënyrë të plotë të agjencive, të cilat janë miratuar edhe nëpërmjet ndihmës së këtij komisioni, në parlamentin e Shqipërisë. Do të jetë buxheti për Agjencinë Kombëtare të Diasporës, buxheti për Qendrën e Botimit të Diasporës dhe buxheti për 3 projektet e miratuara deri tani me fondet e buxhetit të shtetit për Fondin e Zhvillimit të Diasporës Shqiptare.

Risi e këtij buxheti është se me vendim të qeverisë, duke filluar nga 1 janari, do të fillojë funksionimi administrativ i një qendre tjetër për diasporën, që do të jetë Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Kështu që numri i agjencive, që do të kujdesen në vazhdim për aktivitetet e ndryshme dhe të koordinimin e politikës shtetërore të shtetit shqiptar me diasporën, do të shkojë në 4.

Buxheti është rreth 2014 milionë lekë, por ne kemi disa rezerva në lidhje me faktin që nuk është respektuar renditja, që edhe sipas vërejtjeve të këtij komisioni është bërë në buxhetin e vitit 2019, pra në buxhetin e mëparshëm, ku zërat buxhetorë të shpenzimeve për diasporën janë ndarë sipas agjencive. Në buxhetin aktual përsëri ka ardhur si një zë i vetëm, duke e titulluar “Shërbime për diasporën”. Në fakt, “Shërbime për diasporën” është pak e paqartë, sepse do të krijojë keqinterpretime, sepse shërbim për diasporën ofron edhe buxheti i Ministrisë së Jashtme, edhe buxheti i Ministrisë së Kulturës, ofrojnë edhe buxhetet e ministrive të tjera të linjës. Nga pikëpamja e strukturës dua t’i propozoj komisionit që të respektohet struktura, e cila është miratuar në ligjin e buxhetit të vitit 2019.

Shkurtimisht, dua t’ju them se ne do t’i bëjmë një propozim komisionit dhe besoj se kam mirëkuptimin e Ministrisë së Financave dhe do ta kuptoni pse. Ne nuk kërkojmë asnjë shtesë nga viti 2019 për Agjencinë Kombëtare të Diasporës. Domethënë, fondi prej 81,5 milionë, që kanë qenë për vitin e kaluar, të qëndrojnë i tillë edhe për këtë vit. Për Fondin e Zhvillimit të Diasporës do të mbetet vetëm shifra që i konvenon vitit në vazhdim për 3 projektet e miratuara nga qeveria që në mos gaboj është 54,133 milionë, kurse për Qendrën e Botimeve ka qenë 56,5 milionë dhe do të vazhdojë të qëndrojë 56,5 milionë.

Një shtesë të vogël do të kërkoja për Qendrën e Arbëreshëve. Është hera e parë që në mënyrë të qartë dhe të koordinuar, kemi filluar bisedat edhe me shtetin tonë fqinj për të krijuar një homologe të tillë edhe në Itali, me qëllim që më pas t’i japim pamjen e një instituti ndërkombëtar, duke lidhur dy degët në të dyja anët e Adriatikut.

Propozimi ynë ka qenë që të jetë në masën 30 milionë. Nëse do të stabilizohet e gjithë shuma, mund të kërkoj një shtesë prej 15 apo 20 milionë lekë të rinj, e cila besoj se është

plotësisht e realizueshme. Pra, ne nuk kërkojmë asnjë shtesë për agjencitë e tjera ekzistuese në funksion të buxhetit të agjencisë së re, që është për arbëreshët. Kjo është një agjenci, që është mirëpritur goxha mirë nga komunitetet arbëreshe, qoftë në Itali, qoftë në Kroaci apo në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Argjentinë. Ajo do të përfshijë shumë studiues, qoftë të Shqipërisë, qoftë arbëreshë në Itali, në Kroaci dhe më gjerë. Besoj se do të jetë një vlerë e shtuar për marrëdhëniet e shtetit shqiptar me diasporën.

Jam i hapur për çdolloj pyetje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

A keni pyetje, apo diskutime?

Urdhëroni zonja Hajdari!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin!

Kam disa pyetje dhe komente, por, pasi lexova buxhetin e vitit 2020, shikoj se objektivi kryesor në politikën e jashtme është rritja e rolit të diasporës, që është një gjë pozitive. Konkretisht, dua të di nga ju: si synohet të bëhet një gjë e tillë dhe çfarë projektsh janë planifikuar në këtë drejtim për vitin 2020, duke parë që parashikohet një rritje në buxhet? Po ashtu, bazuar në Strategjinë Kombëtare për Diasporën parashikohet që gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2020 të mbarojë regjistrimi i emigrantëve dhe informimi për të drejtën e votës. Zoti Ministër, si do të realizohet efektivisht një gjë e tillë? A është një objektivi që po plotësohet, duke marrë parasysh që kemi një diasporë shumë të madhe? A do të jetë që këta shtetas, të cilët jetojnë jashtë Shqipërisë, thjesht të informohen për mënyrën si do të votojnë, apo do të regjistrohen? Pra, çfarë efekti do të ketë regjistrimi i emigrantëve dhe a do të shërbejë thjesht për evidenca statistikore, apo keni një plan konkret se çfarë do t'i ofrojnë ata shtetit shqiptar?

Po ashtu, dua të di çfarë parashikohet me këtë grup për sa i përket përfitimit të shërbimeve të tyre nga shteti shqiptar? Gjithashtu, në Strategjinë për Diasporën parashikohet zbatimi i programeve kombëtare dhe të përbashkëta me institucionet ndërkombëtare, me qëllim që të tërhiqen anëtarët e kualifikuar të diasporës për t'i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë. Si do të parashikohet të bëhet një gjë e tillë dhe çfarë do t'i bindë këta individë që të kontribuojnë në tregun e Shqipërisë?

Gjithashtu, parashikohet që ju t'i pajisni ata me një certifikatë? Këtu thuhet se gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2020 parashikohet edhe përgatitja e certifikatës së diasporës, e cila

mund të aplikohet *online* dhe më pas do të pajisen me një dokument të printueshëm, që quhet “Jam shqiptar”, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë drejtim, dua të di, nëse ka një vlerë tjetër, përveç vlerës simbolike. Çfarë do të thotë kjo? Pra, disa gjëra konkrete për këto iniciativa që ju keni paraqitur dhe që parashikohen në strategjinë e vitit 2020. Shpresojmë që shërbimet e diasporës t’i kryejnë këto objektiva dhe ne të kemi një diasporë më të angazhuar në shtetin tonë dhe vetë ata të përfitojnë, sidomos të drejtën e tyre për të votuar në zgjedhjet e ardhshme.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zoti Velaj!

Fatmir Velaj – Përsëndetje, zoti Ministër!

Ne sapo jemi kthyer nga një udhëtim në Bruksel dhe unë e përjetova vetë ngazëllimin dhe pritshmërinë e madhe që kishte diaspora jonë atje për punën tuaj. Duke ditur që Brukseli nuk është thjesht një qytet apo një kryeqytet, por është edhe kryeqyteti i gati 500 milionë banorëve, ku diaspora shqiptare në këta 500 milionë banorë zë një vend të vogël, por, pak a shumë, të respektuar. Dua të di nëse ju keni menduar pikërisht në këtë qytet ose në rrethina rreth Brukselit të krijoni një strategji të veçantë që rolin diasporës atje. Ne së bashku përjetuam një konferencë shumë të bukur për Nënë Terezën, takimet apo hapjen e ekspozitës “Vlora, qyteti që po zgjohet”. Nëse ju keni menduar pikërisht këtë diasporë në Bruksel, ku shikueshmëria dhe vizibiliteti është teje i madh nga të gjithë aktorët politikë të Europës, sepse Brukseli nuk është thjesht komisioni apo parlamenti, por aty është edhe Europa e rajoneve, ku çdo krahinë e Europës ka një zyrë dhe bën lobin për krahinën, vendin e tij dhe për çdo gjë tjetër, për të mos folur më pas për 5 mijë lobues, që kanë aty zyrat e tyre, në buxhetin vitit 2020, duke pasur parasysh që ne në samitin Zagrebit presim një përgjigje pozitive, për rolin e diasporës atje, sepse duhet ta nxisim më shumë që të bëjë sa më shumë konferenca, duke dhënë impulse për vlerat më të ndriçuara të popullit shqiptar, siç ishte konferenca për Nënë Terezën.

Së dyti, 10 minuta para se të fillonte mbledhja, më morën nga Vjena në telefon nga një organizata industriale, ku është i gjithë biznesi industrial i Austrisë, pra si dhoma e tregtisë këtu, por ajo është më e madhe. Ata më pyetjen mua për një ftesë që i keni nisur për ndërtimin e një organizate... *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ata donin të dinin. Unë, pak a shumë, e di në mënyrë sporadike nga bisedat me ju. Çfarë mund të na thoni diçka më shumë? si do të funksionojë kjo, në mënyrë që biznesi shqiptar ose shqiptarët që kanë një biznes në vende të ndryshme të botës, të jenë të

inkuadrar dhe të japin impulset e tyre për të ardhur në Shqipëri ose për të lobuar që bizneset kolege e tyre të vijnë në Shqipëri.

Mimi Kodheli – Zoti Ministër, fjala për ju.

Pandeli Majko – Faleminderit!

Mendoj se kolegët më mirëkuptojmë, duke shmangur retorikat e përgjithshme që ne do të bëjmë kështu e ashtu, këtej e andej, pra fjalë të përgjithshme. Publiku i diasporës, përgjithësisht, është një publik shumë metrik. Pra, nuk i ka qejf këto fjalët e përgjithshme, sepse koha ka kaluar dhe ne si shtet jemi shumë vonë në aplikimin e politikave karshi tyre.

Për sa i përket çështjes së votës, ne kemi krijuar një grup të veçantë me teknicienë që drejtohet nga unë me përfaqësues të institucioneve, por këtu dua të bëj një nënvijëzim. Ky grup nuk është për të bërë një rol paralel me Komisionin e Reformës Zgjedhore të parlamentit. Në çdo rast vendimmarrja se çfarë do të bëhet dhe ku do të shkohet për sa i përket reformës zgjedhore në Republikën e Shqipërisë është atribut i Komisionit të Reformës së Kuvendit të Shqipërisë. Ne jemi vetëm për të bërë propozime të natyrës teknike pranë këtij komisioni, duke u koordinuar nëpërmjet këtij komisioni. I tillë është edhe formulimi i urdhrit të Kryeministrit për krijimin e këtij komisioni që ka të bëjë me votën e diasporës. Ka filluar puna dhe besoj se amendamentet brenda muajit dhjetor do të jenë në tavolinën jo vetëm të qeverisë, por edhe të Komisionit të Reformës Zgjedhore, pasi e përsëris dhe kjo ka shumë rëndësi, jo vetëm politike dhe për respekt të ekzekutivit karshi institucionit më të lartë që është parlamenti, që vendimmarrja u takon pozitës dhe maxhorancës në këtë parlament.

Po i rikthehem, sepse janë dy pyetje paralele: çfarë jemi duke bërë dhe cilat janë cilësitë e fundit që kemi realizuar. Mendoj se Qendra e Botimeve të Diasporës ka bërë një evolucion. Besoj se sot nga shkollat shqiptare për diasporën nuk keni dëgjuar që nuk kemi abetare, nuk kemi furnizim me libra. Është hera e parë që furnizimi është bërë i plotë, para se të fillonte viti shkollor. Para një jave qeveria kaloi vendimin për furnizim plus dhe për herë të parë ne do të furnizojmë shkollat shqiptare, me të cilat ne po krijojmë regjistrin e tyre dhe, në bashkëpunim dhe në bazë të ndryshimeve ligjore që ka miratuar ky parlament i nderuar, po krijohet regjistri zyrtar i mësuesve në diasporë, të cilët, sigurisht, duhet të plotësojnë disa kushte. Në këtë kuadër, ne kemi miratuar jo vetëm strukturën e librave, jo vetëm furnizimin me libra, por ka filluar edhe funksionimin. Deri tani janë bërë 4 mbledhjeje nga komisioni i përbashkët midis Shqipërisë dhe Kosovës për kurrikulën e re. Aktualisht midis Shqipërisë dhe Kosovës është vetëm një marrëveshje për një libër dhe kjo është abetarja. Janë bërë 4 mbledhje dhe besoj se jemi në drejtimin e duhur dhe sot mund të kisha konkluzione më të

plota, por për arsye të zgjedhjeve në Kosovë mbledhjet radhës janë shtyrë për një moment pak më të përshtatshëm, pra pasi të krijohet qeveria në Prishtinë.

Para 4 ditësh gjykata e Tiranës ka dhënë miratimin për krijimin e dhomës së biznesit të diasporës. Inaugurimi do të bëhet në datën 27 nëntor. Në bazë të marrëveshjes që ka firmosur qeveria e Shqipërisë me qeverinë e Kosovës në takimin e Pejës, funksionimi i rrjeteve të bizneseve të diasporës do të jetë i përbashkët, nuk do të kemi një dhomë të diasporës së veçantë në Shqipëri dhe një dhomë të biznesit të veçantë në Kosovë, përkundrazi, *network-u* do të jenë njësoj për të gjithë, sepse bizneset shqiptare funksionojnë si të tilla. Po i përmend këto si cilësi, për të cilat ne kemi filluar realizimin. Kam shumë për të thënë, por më lejoni të flas pak shkurt për një arsye shumë të thjeshtë, jo se nuk dua ta jap këtë informacion, por, duke qenë se kemi detyrimin që çdo agjenci të vijë dhe të raportojë edhe me shkrim (për shembull, siç ju vjen buletini çdo 3 muaj i masave të planit të veprimit dhe revolucionit të tyre për sa i përket veprimit dhe realizimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës), ne përsëri do të vijmë këtu, por jo vetëm për rastin e buxhetit.

Regjistrimi i shtetasve tanë jashtë vendit është një nga temat e diskutimit të grupit teknik, që është krijuar. Është ligji për regjistrimin e shtetasve tanë dhe të adresave, por ashtu është edhe kontrata që ne kemi si shtet shqiptar me kompaninë franceze për realizimin e pasaportave. E përmenda këtë të dytën, sepse tani është duke u realizuar për arsye të mbushjes së 10-vjetëve të ID-ve dhe të pasaportave dhe kompania në fjalë po bën edhe zëvendësimin e këtyre dokumenteve. Të dyja këto programe, një program që ka të bëjë me regjistrimin e adresave që mbulohet nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Jashtme, ashtu edhe kjo që po ndodh me rigjenerimin e pasaportave dhe zëvendësimin e pasaportave dhe të kartave të identitetit. Janë dy procese, që mund të na japin një pamje të plotë se kush jeton brenda vendit dhe jashtë vendit.

Për sa i përket strategjisë për të drejtën e votës, mendoj se realizimi i listave të votuesve, që do të votojnë jashtë vendit dhe atyre që do të votojnë brenda vendit, besoj se është një nga cilësitë më pozitive që do të prodhojë e drejta e votës së shtetasve jashtë vendit. Aktualisht, ne në të gjitha qendrat e votimit, ku votojmë, nuk kemi vetëm votuesit që jetojnë në Shqipëri, por kemi edhe votuesit që jetojnë jashtë vendit. Një pjesë e tyre mund të kenë me vite pa ardhur në Shqipëri. Besoj se kjo do të ulë shumë, ta quajmë, efektin psikologjik të manipulimit apo të ashtuquajturës “votimi në emër të dikujt tjetër”.

Për sa i përket mënyrës se si do të koordinojmë në vazhdim, duhet të kemi parasysh se sapo kemi mbyllur vitin e parë të aplikimit të legjislacionit të ri dhe veprimit të agjencive të reja.

Qeveria ka marrë vendimin për të vendosur nga dy oficerë koordinues në Romë, në Athinë, në Selanik dhe në Milano. Ky vendim është marrë dy javë më parë, si rezultat i koordinimit më të mirë të agjencive të diasporës me trupin diplomatik. Më duhet të them se trupi diplomatik, pavarësisht përpjekjes, ka një ngarkesë shumë të madhe për sa i përket marrëdhënies me diasporën. Sipas meje, kjo është marrëdhënia më e rëndësishme, pasi trupi diplomatik duhet t'i kryejë veprimet atje ku ata funksionojnë, sepse, të jemi të singërtë, një trajnim apo një administrim i një natyre të tillë, në eksperiencën administrative të shtetit shqiptar, mungon. Kështu që ka ende shumë punë për të bërë në këtë drejtim.

Më pyetët me të drejtë për certifikatën “Jam shqiptar”. Kjo certifikatë nuk lëshohet për të gjithë, por ne do të fillojmë ta lëshojmë nga viti i ardhshëm, si rezultat i një memorandumit të bërë me katër ministri: me Ministrinë e Arsimit, me Ministrinë e Kulturës dhe me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Koordinatori shtetëror i këtij programi është zëvendësministri i Arsimit dhe fëmijët, që do të vijnë nga diaspora, do të bëjnë një program të caktuar të shoqëruar me mësues specialistë të gjuhës dhe të kulturës. Në fund të programit do të marrin një certifikatë, që quhet “Jam shqiptar” me dizajn, që tashmë është i përfunduar. Vitin që vjen ky program do të zhvillohet me shpenzimet e buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Sot që flasim ne kemi mësues të kontraktuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, të cilët do të japin mësim, do të koordinojnë dhe do të trajnojnë mësues të gjuhës shqipe në Ukrainë dhe në Kroaci për komunitetin arbëresh. Gjithashtu, sot që flasim ne jemi duke zhvilluar disa aktivitete me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Popullore, pasi historia e komunikimit me diasporën nuk mund të mbetet në nivelin politik, në një kohë që ata kërkojnë shumëllojshmëri komunikimesh. Unë besoj se, falë edhe bashkëpunimit me Ansamblin dhe me Ministrinë e Kulturës, vitin që vjen do të kemi në program më të detajuar për sa i përket kësaj, që sapo thashë. Për herë të parë vitin e kaluar, përveç organizmit të samitit të Diasporës, kemi krijuar institucionin Koordinatori Shtetëror për Programin e Kulturës së Diasporës, ku koordinatore do të jetë zëvendësministria e Turizmit, e cila do të bëjë koordinimin e të gjitha institucioneve sipas shteteve përkatëse të diasporës lidhur me atë çfarë do të bëhet, si do të bëhet, kur do të bëhet dhe ku do të bëhet. Ambicia jonë është që të krijojmë javët e kulturës për shqiptarët në të gjitha shtetet, këtu po i përgjigjem edhe pyetjes së kolegut të nderuar Fate Velaj, ku Brukseli, kryeqyteti i Europës, mbetet një nga pikësynimet tona. Javët e kulturës nuk do të jenë thjesht të tilla vetëm për diasporën, por do të jenë edhe javët e kulturës për mënyrën se si ne prodhojmë diplomaci të një natyre tjetër, e cila është shumë funksionale për Europën dhe për mënyrën se si ajo duhet të na shikojë, sepse ende na shikon me një

këndvështrim, të cilin ne e kemi lënë vite pas. Kjo gjë ka ndryshuar, sidomos për sa i përket mënyrës së përfaqësimit dhe mënyrës së prezantimit të njerëzve më të suksesshëm të diasporës, këtë duhet ta themi me zë të lartë, por ka shumë elemente të natyrave të tjera. Unë nuk dua zgjatëm shumë me këtë çështje, sepse do të vij përsëri këtu dhe do t'ju informoj, së bashku me drejtuesit e agjencive, pasi të kem depozituar pranë jush, ashtu siç e kam bërë në vazhdim, informacionin me shkrim për të gjithë veprimtarinë e agjencive. Kjo nuk është thjesht detyrë administrative, sidomos për fondin e diasporës, por është detyrë ligjore, të cilën Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Qendra e Botimeve do të bëjnë të njëjtën gjë para trupës suaj të nderuar. Për sa i përket Qendrës së Arbëreshëve ajo do ta bëjë këtë gjë vitin e ardhshëm, pasi fillon të funksionojë në datën 1 janar.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni - Faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se ju jeni në dijeni të angazhimit tonë, si deputetë të opozitës, në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore, ndaj unë dua të ndalem më tepër dhe të futem më thellë te puna e votës së diasporës. Ne kemi insistuar për një ndryshim rrënjësor të sistemit zgjedhor, jo vetëm për sa i përket sistemit zgjedhor në formatin e tij proporcional apo maxhoritar, për një reformë të thellë zgjedhore, ku unë besoj se vota e diasporës, vota e shtetasve shqiptarë me banim jashtë Shqipërisë duhet të jetë një element thelbësor dhe kyç.

Te parashikimet buxhetore që ju keni bërë unë shikoj se keni shpenzime administrative, shpenzime kapitale, si dhe shpenzime për personelin. Nëse ne do të kryejmë një reformë zgjedhore të mirëfilltë gjatë vitit që vjen, për ta zbatuar në kohë për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021, mendoj se duhet të fillojmë parapërgatitjet, hulumtimin dhe studimin e të gjithë terrenit dhe infrastrukturës së shtetasve shqiptarë me banim jashtë Shqipërisë për të parë se ku jemi dhe sa e realizueshme do të jetë vota e këtyre shtetasve në diasporë.

Pyetja ime është shumë konkrete dhe shumë koncize: pse nuk ka një parashikim buxhetor, një zë me vete për ta realizuar këtë gjë vitin që vjen? Unë besoj se në momentin që ju do të shikoni se ku janë të vendosur këta shtetas, sa e kanë ata të drejtë për të votuar jashtë kufirit të Shqipërisë, ne jo vetëm u japim atyre të drejtën për të votuar, por edhe fillojmë të pastrojmë, siç e thatë edhe ju me shumë të drejtë, listat zgjedhore brenda Republikës së Shqipërisë. Ne do të ishim shumë të gatshëm ta mbështesnim këtë kërkesë legjitime dhe pse nuk e keni kërkuar ju këtë gjë nga qeveria?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Fino, fjala për ju.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Unë kam diçka për procedurë. Ne po diskutojmë projektbuxhetin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën, ndaj pyetja që sapo bëri kolegu, për të cilin kam shumë respekt, është në të drejtën e ministrit të kthejë ose jo përgjigje, unë nuk dua t'i ndërhyj, por besoj se ka të bëjë me një çështje tjetër. Meqenëse unë e njoh shumë mirë buxhetin, mendoj se kjo pyetje ka të bëjë me KQZ-në, sepse KQZ-ja ka disa fonde dhe e di se si veprohet. Ne po diskutojmë këtu për fondet e Ministrisë së Shtetit për Diasporën dhe jo për votimin e shqiptarëve jashtë kufijve, sepse kjo është në kuadrin e zgjidhjes apo diskutimit në Komisionin e Reformës Zgjedhore. Domethënë, në momentin kur KQZ-ja të vijë për të raportuar në Komisionin e Ligjeve, ne mund t'ia bëjmë pyetjen direkt: a keni fonde të planifikuara, në qoftë se vitin e ardhshëm bëhen zgjedhje të parakohshme, sepse viti 2020 është vit normal, kurse viti 2021 është vit zgjedhjesh? Nga kjo pikëpamje, unë mendoj se ministri i Shtetit për Diasporën nuk e ka tagrin që të kthejë përgjigje për shifrat e KQZ-së. Ky është mendimi im dhe nga kjo pikëpamje është e drejta e tij nëse do apo jo të kthejë përgjigje.

Zonja kryetare, unë kam një pyetje më të drejtpërdrejtë për ministrin. Unë mendoj se ministri i Shtetit për Diasporën, siç e tha edhe ai vetë, në këtë projektbuxhet është i privilegjuar me fondet që ka marrë, sepse janë rreth 205 milionë apo 204 milionë lekë, dhe me numrin e punonjësve të Agjencisë së Diasporës, por edhe të agjencisë tjetër që kemi krijuar, janë 15 me 15, pra janë mbi 30 veta. Një pyetje të cilën unë e kam totalisht teknike, por edhe politike, ka të bëjë me çështjen që Kuvendi i Shqipërisë ka marrë disa vendime gjatë sesionit të kaluar dhe në vazhdimësi, edhe në mbështetje të propozimeve tuaja për shtimin e funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe një nga këto ka qenë hapja e zyrave të diasporës në çdo njësi vendore. Sa ka luftuar ministri Majko, si ministri i kësaj qeverie, dhe çfarë masash ka adresuar në këto zyra, të cilat ne i kemi miratuar në ligjin “Për njësitë e qeverisjes vendore”?

Unë shikoj në projektbuxhet se fondet për Ministrinë e Shtetit janë të mjaftueshme, madje mund të them se janë të kënaqshme, sepse gjithnjë kërkohet më shumë, dhe këto fonde për të shoqëruar funksionet, për të cilat ministri ka kërkuar, ne i kemi mbështetur dhe i kemi miratuar, dhe, pavarësisht se Presidenti na e ktheu ligjin e diasporës për hapjen e zyrave në të gjitha njësitë vendore, nuk ka shtim të fondeve për njësitë e qeverisjes vendore, në të cilat ju do të punoni si ekip, jo vetëm si ministër i Shtetit. A do të ishte mirë që të ne të ndikojmë edhe te njësitë e qeverisjes vendore, në mënyrë që, kur t'iu shtohet një funksion, kjo të shoqërohet edhe me faturë financiare?

Mimi Kodheli – Fjalën e kanë zoti Sterjovski, zoti Karamelo dhe zoti Gjoni.

Vasil Sterjovski – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Ministër, unë kam një pyetje. Ju, si Ministri e Diasporës, a bëni thirrje për mbështetje të shoqatave të qytetarëve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë Shqipërisë? A i mbështesni ata financiarisht në zhvillimin e kulturës, të gjuhës dhe traditës? Në këto thirrje a kanë të drejtë dhe a kanë konkurruar edhe pjesëtarët e pakicave, të cilët janë qytetarë shqiptarë, por që jetojnë jashtë kudo në Europë? A keni kontakte edhe me shoqatat e pakicave, që janë qytetarë shqiptarë në diasporë? Këtu po flas konkretisht për komunitetin maqedonas me origjinë nga Shqipëria, e cila është organizuar shumë mirë në Kanada, në SHBA-të, në Itali, sepse ata organizojnë përvjetorë, sidomos për festat fetare. Për shembull, në datën 19 në Kanada kanë një festë fetare, ku do të mbillen të gjithë maqedonasit e pakicës kombëtare nga Shqipëria. Pra, a keni kontakte me këto shoqata dhe a i mbështesni komunitetet e pakicave? Ne mund të marrim si shembull Republikën e Maqedonisë, ku Ministria e Diasporës dhe Agjencia e Diasporës së Maqedonisë, mesa kam i ndjekur, po e mbështesin të gjithë komunitetin maqedonas, që jeton jashtë Maqedonisë, pavarësisë përkatësisë etnike, nëse janë maqedonas shqiptarë, turq apo serbë. Pra, a ka një praktikë të tillë ministria juaj?

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Po, zoti Karamelo.

Ligoraq Karamelo – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Ministër,

Pa dyshim, dua t'ju falënderoj për punën e mirë, sepse kemi ndjerë që sektori juaj ka pasur vërtet aktivitete, të cilat ju po i mbulonit, si evidentim të vlerave, në qoftë se do t'i quaj të tilla, qoftë të kulturës, të traditës apo të historisë. Më konkretisht, dua të di lidhur me disa çështje, të cilat besoj se janë pak të kontestuara, jo sepse dyshoj në sinqeritetin dhe në përkushtimin tuaj, së pari, është problemi i regjistrimit të emigrantëve. Unë nuk e di me saktësi procesin e regjistrimit, por ka hipoteza dhe mendime që ky proces është i njëanshëm, nuk është gjithëpërfshirës, por, ndoshta, ka edhe prapavija politike. Sipas informacioneve që kemi, në të janë aktivizuar edhe struktura të Partisë Socialiste nëpër vendet ku ato po kryhen. Për rrjedhojë, ky proces duket në dukje është shumë pozitive, por ka esencë politike. Unë do të doja të dija: a ka një informacion të saktë se sa shqiptarë ka sot në botë dhe ku ndodhen ata? Ne shpeshherë u referohemi shifrave të qeverive të huaja për emigrantët tanë, ndërkohë që qeveria shqiptare nuk ka shifra konkrete për shtetasit e saj.

Së dyti, një tjetër problem që mendoj se duhet të na shqetësojë në këtë drejtim është çështja e dhjetëra mijëra shqiptarëve, të cilët e kanë humbur shtetësinë shqiptare ose kanë hequr dorë me dëshirë prej saj. Ky është një problem, të cilin mendoj se Ministria e Diasporës duhet ta ndjekë dhe duhet ta trajtojë. Përsëri kemi informacione që ka shtetas, që e kanë humbur shtetësinë shqiptare, të cilët jetojnë dhe punojnë në administratë shtetërore në Shqipëri, madje mbajnë edhe poste.

Problemi i tretë, pak a shumë, ka të bëjë me atë që tha edhe kolegu im i mëparshëm. Ne duhet të kemi shumë kujdes me shoqatat, të cilat kanë krijuar të gjitha pakicat kombëtare jashtë Shqipërisë. Për këto shoqata të krijuara qoftë në rang fshatrash, qoftë në rang krahinash apo edhe më gjerë, është pozitiv fakti se krahas entitetit të tyre, ato manifestojnë edhe vlerat e entitetit shqiptar. Kështu, mendoj se këto shoqata nuk duhen përjashtuar, por duhen trajtuar si pjesë e entitetit shqiptar, sepse të gjitha kulturat bashkëjetojnë dhe nga kjo bashkëjetesë lindin edhe vlerat. Kështu, unë gjykoj se edhe në këtë drejtim ju, si Ministri e Diasporës, duhet ta keni parasysh këtë gjë, pa dashur të theksoj se edhe në rastin e samitit do të ishte pozitiv nëse aty do të kishte edhe figura, që të përfaqësonin pikërisht këto vlera të këtyre pakicave, por që, në fakt, janë shqiptarë. Kjo gjë ndodh edhe me të tjerët, sepse ne sot shikojmë grekë apo shqiptarë, të cilët janë dikush dhe vlerësohen edhe në Amerikë, vlerësohen edhe në Greqi, vlerësohen në Shqipëri, vlerësohen në Maqedoninë e Veriut apo edhe vende të tjera. Kështu që mendoj se, në kontinuitetin midis vlerave, duhet ta trajtojmë, pa dashur të bëjmë retorika nacionaliste për t'i dhënë populizëm një çështjeje që ka të bëjë me identitetin e vlerave të Ballkanit në përgjithësi, por edhe të Shqipërisë në veçanti.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Gjoni, kishit në sqarim, apo jo?

Ralf Gjoni - Po, faleminderit!

Duke marrë shkas nga sqarimi shterues i kolegut Fino, të cilin gjëj rastin ta falënderoj, sepse është gjithnjë konstruktiv dhe kontributor, thjesht dua të sqaroj pyetjen time, zoti Ministër.

(Diskutime pa mikrofon)

A mundem, kolegë?

(Diskutime pa mikrofon)

Si ka mundësi, sepse unë nuk ju ndërhyra. Unë nuk kam nevojë për përkthyes, ndaj, ju lutem, më lejoni të bëj pyetjen.

Zoti Ministër, unë dua ta bëj më të qartë pyetjen, sepse ndoshta nuk u shpreha siç duhet. Unë jam shumë i qartë se Ministria e Shtetit për Diasporën nuk është përgjegjës për

reformën zgjedhore apo për të drejtën e votës, këtë e kemi ne si komision i posaçëm në parlament, si dhe jam shumë i qartë për rolin e KQZ-së dhe detyrat e saj. Pyetja ime ishte e drejtpërdrejtë: a ka një zë dhe, nëse jo, pse nuk ka një zë buxhetor për identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve shqiptarë jashtë Republikës së Shqipërisë? Këtë gjë unë e shikoj të lidhur me terrenin ku ne po operojmë për reformën zgjedhore.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Ministër, unë rezervova të drejtën e pyetjes në fund të kolegëve. Unë do të kisha dashur ta bëja pyetjen, pasi të kishit dhënë përgjigjet e shumë pyetjeve që u thanë këtu, por besoj se zonja që është këtu, ju dhe zëvendësministri i Financave mbani shënime, kështu që do ta keni më të thjeshtë t’u përgjigjeni pyetjeve tona. Unë kam një koment dhe disa pyetje.

Pyetjen time të parë e kam për zëvendësministrin e Financave. Unë shikoj në detajimin buxhetor, në zërin “Shërbimi për diasporën”, që nuk e keni ndarë se për çfarë janë këta zëra? Unë mund të jem gabim në këtë që kërkoj, por ne jemi këtu për t’u sqaruar.

Pyetjet për ju, zoti Ministër.

Vërej se në projektbuxhet shërbimet për diasporën dhe mbështetja për shoqërinë civile kanë pothuajse të njëjtën shumë parash. Me gjithë respektin për shoqërinë civile, por që shpenzimet për diasporën dhe shpenzimet për shoqërinë civile të jenë pothuajse të njëjta, personalisht kjo më lë një perpleks.

Së dyti, ju keni kërkuar dy punonjës më shumë nga viti 2019 për Qendrën e Botimeve të Diasporës. Unë dua të di pse?

Së treti, ju përgëzoj për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, por në projektbuxhetin e vitit 2020 nuk ka asnjë zë për këtë Qendër, qoftë që të justifikojë edhe qëllimin e funksionimit të Qendrës, në një kohë që në listën e emërimeve të ministrive dhe institucioneve buxhetore, që na vjen nga qeveria, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët është atje, madje me 12 persona. Unë kërkoj prej jush një justifikim apo një arsye: pse nuk ka asnjë zë në buxhet lidhur me fillimin krijimit të Qendrës?

Kam një koment për diskutimet që po bëjmë. Nga informimi që unë kam nga mediet, paralelisht me diskutimin e projektbuxhetit të vendit tonë është duke u diskutuar edhe projektbuxheti i Serbisë. Serbia ka anoncuar në projektbuxhetin e saj shumën 89 milionë euro për institucionet e veta paralele në Kosovë, që përfshijnë 29 komuna, të ashtuquajtura organe të përkohshme, të cilat Kosova nuk i njeh, por vazhdojnë të funksionojnë sipas një teorie të vjetër të mënyrë së organizimit të shtetit serb.

Zyra serbe në Kosovë, sipas projektbuxhetit serb, do të harxhojë vitin që vjen 63,7 milionë euro. Presheva, Bujanovski dhe Metvegja, krahina të banuara nga shqiptarët, më të varfrat në Serbi, do të përfitojnë vetëm 3,3 milionë euro nga ky projektbuxhet.

Nuk dua të bëj asnjë paralelizëm, por a është ky “një shembull” për t’u ndjekur? Gjithmonë? Ne i kemi shembujt më të mirë vetë, nuk kemi nevojë t’i marrim nga fqinjët, por a jemi ne në rrugën e duhur? Patjetër që jemi në rrugën e duhur, por a jemi duke nxituar drejt kësaj rruge nëpërmjet mbështetjes me paratë e buxhetit të vitit që vjen ashtu siç duhet, apo jo? Prandaj e solla këtë shembull. A duhet që ne t’ju japim juve më shumë mbështetje lidhur me rivitalizimin e mëtejshëm të një diaspore të konsiderueshme rreth e rrotull globit? Pyetja nuk është retorike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund ta bëni komentin pasi të përgjigjet ministri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

Person – M’u kujtua diçka, pasi folët për vitin 2020. Mua m’u kujtua Gerhard Shröder, ish-kancelari i famshëm gjerman, i cili kishte axhendën e tij *zweitausendzehn* (2010). Ajo ishte e gjithë axhenda e qeverisë së tij. M’u kujtua Angela Merkel, që kur prezantoi libri e tij “*Entscheidungs*”, që do të thotë “Vendimmarrje”, tha: “Gjermania nuk do të ishte kjo që është sot, nëse Gerhard Shröder nuk do të kishte startuar axhendën 2010”. Më pëlqeu ajo që thatë ju, ndaj ndërhyra.

(Diskutime pa mikrofon)

Pandeli Majko – Po filloj me komentet e zotit Gjoni dhe të zonjës Hajdari për pyetjen; pse nuk ka një fond buxhetor tek Agjencia Kombëtare e Diasporës për votat e diasporës? (Të më korrigjojnë kolegët që kanë qenë prezent në Komisionin e Jashtëm kur është diskutuar ligji i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.)

Projektligji ka ardhur që Agjencia ta mbulonte edhe këtë çështje, por ka qenë insistimi i opozitës në këtë komision, që në mënyrë absolute të mos ekzistonte si një çështje që do të mbulohej nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, sepse u konsiderua si një moment që mund të politizonte procesin e votës së shtetasve tanë jashtë vendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, opozitës që ka qenë prezente kur është diskutuar.

Me konsensus është hequr, ndaj kjo është arsyeja pse nuk ka zë buxhetor apo buxhet të veçantë tek Agjencia Kombëtare e Diasporës për këtë çështje.

Për sa i përket pyetjes së kolegut Fino për strukturën administrative, që quhet Zyra e Emigracionit dhe Diasporës, e cila u shtua me ndryshimin e ligjit për pushtetin lokal, aktualisht ne kemi rreth 2-3 javë që i kemi dërguar. Besoj se do të dalë shumë shpejt konkluzioni i aktit nënligjor për këto zyra, pasi kjo strukturë administrative kërkon një akt nënligjor para se të fillojë funksionimin. Të them të drejtën, na ka marrë pak kohë procesi i koordinimit, por ne filluam menjëherë, sapo parlamenti miratoi për herë të dytë ligjin që po flasim, sepse duhet bërë edhe një përshkallëzim. Struktura organizative e emigracionit dhe e diasporës në bashkitë e mëdha do të jetë drejtori, në bashkitë e mesme do të jetë sektor, ndërsa në bashkitë e vogla do të jetë thjesht një zyrë. Pa diskutim, ne do të na keni në krah, por mendoj se ky do të jetë një proces në vazhdim.

Për sa i përket diskutimit të buxhetit për pushtetin lokal, gjykoj se krijimi i një strukture administrative të tillë është plotësisht i zbatueshëm nga ana e pushtetit lokal jo vetëm nga pikëpamja financiare, por edhe nga dobishmëria.

Për pyetjen e zotit Sterjovski: nëse fondi i diasporës mbështet shqiptarët, a mund të mbështesë edhe minoritetet e tjera? Jo, nuk mund t'i mbështesë. Më mirëkuptoni pse po ju flas me këtë gjuhë!

E para, dua të jem i sinqertë me ju.

E dyta, sepse kështu është e shkruar në ligj. Fondi Shqiptar i Diasporës është vetëm për shqiptarët jashtë vendit. Unë bashkëpunoj shumë mirë me kolegun, ministrin e Diasporës së Maqedonisë, i cili, përveç se është shqiptar, kur shkon jashtë vendit, në mënyrë të qartë merret jo vetëm me diasporën shqiptare të Maqedonisë, por edhe me diasporën maqedonase pa asnjë dallim. Në këtë pikë ka komplimentin tim të plotë.

A ka prapavijë politike regjistrimi i shtetasve jashtë vendit? Nuk mund të ketë prapavijë politike, sepse procesi i regjistrimit do t'i vendosë qytetarët në një marrëdhënie të barabartë. Nuk mund të ketë një regjistrim të dikujt pse është socialist dhe një mosregjistrim të dikujt tjetër pse ka një bindje tjetër. Kjo nuk mund të bëhet, në asnjë rast, me angazhimin e strukturave partiake që mund të ketë një parti apo tjetra jashtë vendit. Në momentin që ti, si qytetar, aplikon se je jashtë vendit dhe je në listën e votuesve, gjithçka është e sqaruar dhe askush nuk ta heq të drejtën të votosh sipas dëshirës tënde. Numri i emigrantëve jashtë vendit në mënyrë të detajuar ndiqet nga institucioni përgjegjës, nga INSTAT-i, i cili botoi vjet raportin e parë. Ne jemi në pritje që në muajin dhjetor të nxjerrin raportin e dytë për këtë çështje, që është edhe një komunikim me të gjithë homologët e tyre në vende, sidomos të Bashkimit Europian, dhe më gjerë. Kini parasysh që është eksperiencia e parë dhe INSTAT-i

duhet justifikuar nëse ka ndonjë ngadalësim në këtë pikë. Bashkëpunimin me ta, ne e kemi pasur jashtëzakonisht pozitiv.

Për sa u përket pyetjeve të kryetares, po i lë për në fund, por jo për nga rëndësia e përgjigjes.

Ne i kemi marrë shtesë punonjësit e Qendrës së Botimit të Diasporës. Për sa i përket punonjësve të Qendrës së Arbëreshëve, çështja është se kur është miratuar dhe diskutuar PBA-ja me Ministrinë e Financave, VKM-ja nuk ishte miratuar ende. VKM-ja për Qendrën e Arbëreshëve është miratuar në shtator, kështu që ne do t'i plotësojmë këto gjëra gjatë kohës në vazhdim. Ministria e Financave, të cilën e falënderoj, ka parashikuar në buxhet ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka nevojë, sepse është parashikuar. Pika më delikate është numri i punonjësve, që është parashikuar të jetë 12. Përveç 12 punonjësve të administratës, do të jetë një këshill me studiues, që do të jenë brenda dhe jashtë vendit. Ata mund të paguhen në një mënyrë tarifore, por kjo do të shikohet nga vlerësimi në vazhdim i situatës, pasi një nga qëllimet e Qendrës është të ndihmojë dhe të subvencionojë studiuesit brenda dhe jashtë vendit.

Për sa i përket situatës së buxhetit për Serbinë, ne po flasim për buxhetin e diasporës, e cila, edhe nga pikëpamja e të drejtës ndërkombëtare, është komunitet i një natyre tjetër. Buxheti 89 milionë ka të bëjë me politikën e një shteti tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk besoj se paralelja është shumë e gjetur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo nuk mbulohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja kryetare, unë kam ftesa për të vizituar shumë nga territoret etnike të shqiptarëve në rajon dhe i shmang me qëllim, sepse jam ministër i Diasporës. Vizita ime atje do të konsiderohej si vizitë në diasporë, ndërkohë që ata nuk janë në diasporë, por janë në trojet e tyre, që ua kanë lënë babagjyshët denbabaden, siç thotë një shprehje.

Për rastin e Preshevës, këto fonde mbulohen nga Ministria e Jashtme, jo nga ministri i Shtetit për Diasporën. Besoj se shpjegimi im është pak i thatë, por është i mjaftueshëm. Ju më kuptoni shumë mirë.

Elton Haxhi – Përsëritje!

Për sa i përket pyetjes suaj, nëse duhet detajim, dokumenti që ju i referoheni është çështje teknike e buxhetit, thjesht në nivelin e programit buxhetor. Programi buxhetor rri në

këtë nivel. Nëse doni të shikoni detajet, duhet t'i referoheni PBA-së, ku janë edhe produktet apo aktivitetet e kostuara një më një.

Mimi Kodheli – Unë bëra një koment, që aq sa i japim shoqërisë civile, ju japim edhe juve si diasporë. Nuk keni ndonjë përgjigje? E lini thjesht në nivelin e komentit që bëra unë si kryetare e komisionit?

Pandeli Majko – Po e lë në nivelin e një heshtjeje mjegulluese.

Mimi Kodheli – Heshtje mjegulluese.

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Ministër, më bëri përshtypje përgjigjja që i dhatë pyetjes së kolegut Fino për ndryshimet e fundit që ne bëmë në ligjin për qeverisjen vendore. Ne sot do të fillojmë diskutimin në Komisionin e Ligjeve dhe zoti Fino do të ketë konflikt interesi për këtë ligj, sepse është relator. Ju thatë se në çdo bashki do të krijohen drejtori për diasporën, në çdo njësi do të kemi sektorë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, të mbaroj!

Ju thatë se qeverisja vendore nuk e ka të vështirë ta krijojë këtë strukturë. Unë i mbajta shënim ato çfarë ju thatë.

Në fakt, ne do ta diskutojmë buxhetin e organeve të qeverisjes vendore në Komisionin e Ligjeve, por, nga ana tjetër, pritshmëria që keni ju nga bashkitë është relativisht e lartë, sepse kërkon rritje stafi dhe buxhet. Si është menduar të bëhet kjo? Ne bëmë ndryshimin në ligj dhe i dhamë shumë kompetenca organeve të qeverisjes vendore. Si është konceptuar dhe sa mundësi keni brenda buxhetit tuaj për të bashkërenduar punën me organet e qeverisjes vendore?

Mimi Kodheli – Zoti Ministër.

Pandeli Majko – Pyetja është me vend, por dua të bëj një sqarim.

Në aktin nënligjor që ne kemi në diskutim do të bëhet një ndarje, por jo për ta çuar te njësitë e qeverisjes vendore. Bëhet fjalë vetëm për në bashki, por duhet të bëhet një ndarje. Bashkitë e mëdha do të jenë në nivel drejtorie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do të jetë vetëm për diasporën, (ju jeni mësuese e së drejtës), por do të jetë për diasporën dhe emigracionin. Kjo çështje është edhe për ata që janë jashtë, por edhe për problematika të natyrave të ndryshme. Kjo nuk përcakton që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkia e Tiranës mund ta kenë nivelin e drejtorisë. Një bashki tjetër, e nivelit të mesëm, do ta ketë në nivelin e sektorit, dhe një bashki e vogël do ta ketë në nivelin e një zyre.

Unë mund t'ju them se ky është opinioni im personal, pra që bashkitë, pavarësisht se do të kenë fondet shtesë, dhe besoj se zoti Fino do të jetë në krahun tim në këtë pikë, një pjesë e tyre kanë shumë rezerva për sa i përket personelit. Unë nuk dua të bëhem ekspert, ata do ta bëjnë vetë strukturën, por mendoj se është një nga strukturat më të dobishme në funksion të marrëdhënieve me qytetarët e tyre brenda dhe jashtë vendit. Sot nuk ka familje në Shqipëri që nuk ka dikë jashtë dhe që quhet diasporë.

Mimi Kodheli – Dakord, zoti Ministër.

Unë do të kërkoja diçka nga Ministria e Financave, por sigurisht edhe nën kujdesin tuaj. Në raportin përfundimtar që ka sjellë Ministria e Financave për diskutim këtu, që mban titullin e projektligjit për buxhetin, nuk ka absolutisht asnjë fjalë, asnjë fjali për diasporën. Do t'ju lutesha ta keni në vëmendje këtë gjë dhe kur të risillni draftin përfundimtar për miratim në parlament, të paktën të jetë e shkruar diku një fjali për diasporën, përndryshe nuk kemi pse të kemi ministër për Diasporën dhe për gjithë këtë aktivitet.

Pandeli Majko – Zonja kryetare, ju keni shumë të drejtë, por në buxhet duhet të përmendesh me matematikë, me shifra, jo me fjalë. Mund të të lavdërojnë në dy faqe dhe të heqin gjysmën e buxhetit, kështu që ...

Mimi Kodheli – Në raportin shoqërues, zotëri.

Pandeli Majko – Vërejtja juaj është shumë e drejtë.

Bashkim Fino – Më mirë që nuk ka asnjë fjalë në relacion dhe ka shifra në buxhet sesa të mos kishte shifra në buxhet dhe ...

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Unë thashë se meqë ka shifra, e kanë të thjeshtë të shtojnë një fjali.

Pandeli Majko – Zonja kryetare, thashë që buxhetin për agjencitë i dua sa kanë qenë vitin e kaluar. Të më japin buxhetin për Qendrën e Arbëresheve dhe me mua janë në rregull.

Mimi Kodheli – Komplimente për këtë ide!

Pandeli Majko – Faleminderit!

Kam rënë dakord me zëvendësministrin.

Mimi Kodheli – Sipas kalendarit, në diskutimin nën për nen, pasi kemi shtruar gjithçka në diskutimin në parim, duhet të jeni prezent ju ose dikush tjetër. Ju njoftoj se për shkak të ngarkesës së madhe që ka në komisione, në datën 21 të mbledhemi në orën 15:00 pasdite, kështu nuk do të shqetësojmë asnjë nga kryetarët e komisioneve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër. Ne mblihdemi për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi në pritje të përgjigjes së kabinetit të ministrit.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA